DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-14/7
Data Datum Date 31.01.2013

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 22/01/2013
Nr. 0104-14

**PËR:** Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Njazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit,

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, NR. 01/011-13251

Pranuar me datë: 09/01/2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit të miratuar me datë 18/10/2012, nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili ka efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr.01/011-13251, mbi dhënien në shfrytëzim -me koncesion të Pronës Komunale.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-III- Nr. Br. No. 0204-14/7
Data Datum Date 31.01.2013

# Republika e Kosovës
# Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum,22.01.2013
Br. 0104-14

**Za:** Ramadan Muja, Gradonačelnik opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući skupštine opštine Prizren ,

**Predmet: Potvrda zakonitosti odluka skupštine opštine Prizren**

Primljeno dana 09.01.2013.
Br. 13251

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, zakon br. 03/z-049 o finansijama lokalne vlasti , dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva ,nakon razmatranja odluka. odobreno dana 18.10.2011. od strane Skupštine opštine Prizren , POTVRĐUJE zakonitost akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akat sa potpunim pravnim dejstvo je kao što sledi:

- Odluka br. 13251,o davanju na korišćenje sa koncesijom opštinske imovine.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović**
**Zamenik premijera i ministar MALS-a,**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Direktorima odeljenja i kancelarija*
*Arhivi MALS-a*

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2 dhe 3 të Udhëzimit administrative nr.2012/02 të MAPL, nenit 12 al. 2, pika c, nenit 14, al. 1 dhe nenit 40, al 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 18 tetor 2012, mori këtë:

# VENDIM
## MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM-ME KONCESION TË PRONËS KOMUNALE

### Neni 1

**APROVOHET** propozimi i Komisionit Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim, ashtu që LEJOHET dhënia në shfrytëzim me koncesion, e pjesës prej 113m/2, së ngast. Kadastrale nr. 7065/2 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 127m/2 , që evidentohet si PSH KK Prizren, e pjesës prej 19m/2, së ngast. Kadastrale nr. 7068/2 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 335m/2 , që evidentohet si PSH KK Prizren, e pjesës prej 103m/2, së ngast. Kadastrale nr. 7064/2 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 125m/2 , që evidentohet si PSH KK Prizren, me qëllim të realizimit të ndërtimit të bllokut urbanistik Z-2, e paraparë me Planin Rregullues Urban Kuadrati E-5.6, E-5.9 dhe një pjesë e kuadratit f-5.2, nr.01/011-2341, të datës 29 02 2012.

### Neni 2

Në bazë të këtij Vendimi, autorizohet Kryetari i Komunës, që në pajtim me ligjet që janë fuqi, të hyjë në koncesion për pronat e cekura më lartë në pajtim me nenin I. të këtij Vendimi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

### Neni 3

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i komunës, Sektori i Çështjeve pronësoro juridike dhe Avokati publik Komunal.

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunë së Prizrenit.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 09.01.2013
-III- 0204-14 20

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-13251
Më 18 tetor 2011
Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu